

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

|                              |                   |
|------------------------------|-------------------|
| Nr <sup>1</sup> i prokurimit | 631-26-5072-5-2-1 |
| Nr i brendshëm               | 631 26 011 521    |

Sa i përket tenderit për: "Ndërtimi i Kanalizimit Fekal ne rrugën "Verrat e Llukës" dhe ne Komunen e Deçanit".

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**Denisi SH.P.K.**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Deçan, 8, Demonstratave**

(Adresa)

**Deçan**

**51000**

(Vendi)

(Kodi postar)

**+38344666988**

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

**Shkelzen Kuçi**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**denisi.ntp@gmail.com**

(Adresa elektronike)

**20.07.2026**

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## **2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

## **3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Data e njoftimit për kontratë: 24.06.2026

Data e planifikuar e hapjes së ofertave: 21.07.2026 në ora 14:00

Kërkesa për rishqyrtim dt.08.07.2026

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt:10.07.2026

## **4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po**

☐

**Jo**

☒

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

## **5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së  
Neni 7 i LPP-së  
Neni 27 i LPP-së  
Neni 69 i LPP-së  
Neni 17 i RRPP Nr.001/2022  
Neni 25 i RRPP Nr.001/2022.

**\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Data e njoftimit për kontratë: 24.06.2026, kurse data e planifikuar e hapjes së ofertave ka qenë e parashikuar të bëhet me 16.07.2026 në ora 14:00.  
Ne pasi kemi analizuar dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë kemi ardhur në përfundim se kërkesat e dosjes së tenderit janë diskriminuese dhe realisht kufizojnë konkurrencën, ndërsa shpijnë në favorizim të ndonjë kompanie.

Fillimisht po e sqarojmë se ne me dt.01.07.2026 kemi dërguar kërkesë për informacione shtesë tek AK-ja, ku i kemi parashtruar pretendimet tona, mirëpo të njëjtat nuk janë marr parasysh nga ana e AK-së, prandaj ne kemi qenë të detyruar të parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim dhe tani ankesë, me pretendimet si në vijim:

Në dosje të tenderit është kërkuar *"Një (1) Inxhinier (Master) i diplomuar i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, me pesë (5) vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme dhe i licencuar nga MMPH"*.

Sa i përket kërkesës së lartcekur ne në kërkesën për informacione shtesë kemi kërkuar: *Kur kemi parasysh natyrën e punimeve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit, kërkojmë nga autoriteti kontraktues të rishqyrtojë këtë kërkesë dhe të largojë kërkesën që Menaxheri i Projektit të jetë i licencuar nga MMPH, pasi për realizimin e kontratës mjafton që personi i propozuar të jetë Inxhinier (Master) i diplomuar i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, me pesë (5) vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme.*

*Kërkesa për licencim nga MMPH nuk është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të parapara në paramasë dhe si e tillë paraqet një kriter joproporcional që kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik të interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit.*

Sa i përket pretendimit tonë të lartcekur AK-ja ka dhënë përgjigjen si në vijim:

**II.** Sa i përket pretendimit tuaj se kërkesa për licencim nga MMPH nuk është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të parapara, sqarojmë se licencimi profesional është vendosur si një mekanizëm shtesë sigurie.

Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimit përbën punë ndërtimore që kërkojnë drejtim profesional nga person i licencuar sipas legjislacionit në fuqi. Licenca nuk është kërkuar si kriter formal pa lidhje me kontratën, por si garanci që punimet do të udhëhiqen nga person kompetent dhe i autorizuar.

Kjo kërkesë është në përputhje me nenin 65 të LPP-së, pasi lidhet drejtpërdrejt me kapacitetin profesional dhe teknik të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës.

Përgjigjja e autoritetit kontraktues vetëm sa e vërteton se pretendimi ynë është i bazuar. AK-së nuk ka mundur në asnjë mënyrë të argumentojë se përse licencimi nga MMPH është i domosdoshëm për realizimin e punimeve të këtij aktiviteti të prokurimit, por është mjaftuar vetëm me konstatime të përgjithshme duke e cekur se licencimi përbën një "mekanizëm shtesë sigurie" dhe se punimet duhet të udhëhiqen nga një person kompetent dhe i autorizuar.

Sa për sqarim pretendimi ynë nuk ka qenë se punimet nuk duhet të udhëhiqen nga një person profesionist, por se kërkesa për licencim nga MMPH nuk është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe objektin e kontratës. Vetë fakti që një licencë shihet nga AK-së si një "mekanizëm shtesë sigurie" tregon se ajo nuk është një kërkesë e domosdoshme për realizimin e kontratës, por një kusht shtesë që tejkalon nevojat reale të aktivitetit të prokurimit.

Po ashtu, referimi i AK-së në nenin 65 të LPP-së nuk mjafton për të justifikuar këtë kriter, për faktin se ky nen kërkon që kriteret e kualifikimit të jenë proporcionale dhe të lidhura me objektin e kontratës. AK-ja nuk ka arsyetuar në asnjë moment se cilat punime konkrete të paramasës kërkojnë domosdoshmërisht që Menaxheri i Projektit të jetë i licencuar nga MMPH, ndërsa kërkesa që personi të jetë Inxhinier (Master) i Ndërtimtarisë me pesë (5) vite përvojë profesionale është plotësisht e mjaftueshme për të garantuar kapacitetin profesional për realizimin e kontratës. Për rrjedhojë, kërkesa për licencim nga MMPH

mbetet një kriter joproporcional dhe kufizues i konkurrencës, andaj kemi kërkuar që e njëjta të largohet në tërësi nga dosja e tenderit.

Në dosje të tenderit është kërkuar *"Kërkesa 2 Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 10 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, moshën e punëtorit, profesioni, eksperiencën (vite) dhe pozicionin në kompani **ku njeri nga këta duhet të jetë i certifikuar për vlerësim të gjendjes së gypave sipas standardit DIN EN 13508-2-2001**".*

Kërkesa që një anëtar i stafit të jetë i pajisur me Certifikatë për vlerësimin e gjendjes së gypave sipas standardit DIN EN 13508-2:2001 nuk është në lidhje logjike dhe funksionale me objektin e kontratës. Objekti i këtij aktiviteti të prokurimit është ndërtimi i ri i rrjetit të kanalizimit fekal dhe jo inspektimi, diagnostikimi apo rehabilitimi i rrjeteve ekzistuese. Standardi DIN EN 13508-2 zbatohet për inspektimin me kamera (CCTV), kodifikimin dhe vlerësimin e defekteve të kanalizimeve ekzistuese, prandaj kërkitimi i kësaj certifikate nuk është i domosdoshëm për realizimin e punimeve të ndërtimit të kanalizimit të ri. Për rrjedhojë, kjo kërkesë nuk është proporcionale me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit dhe kufizon pa nevojë konkurrencën, pasi përjashton operatorë ekonomik që kanë kapacitet të plotë për ndërtimin e kanalizimeve, por që nuk disponojnë personel me një certifikim që nuk lidhet me punimet objekt prokurimi. Prandaj kërkojmë që kjo kërkesë të largohet në tërësi nga dosja e tenderit, me qëllim të hapjes së konkurrencës dhe të mos diskriminimit të OE me përvojë të madhe në fushën e këtij aktiviteti të prokurimit.

Gjithashtu, kërkesa që një anëtar i stafit të jetë i pajisur me Certifikatë për vlerësimin e gjendjes së gypave sipas standardit DIN EN 13508-2:2001 është edhe joproporcionale nga aspekti i konkurrencës, pasi në Republikën e Kosovës nuk ekziston një institucion apo trup i autorizuar që ofron certifikim të tillë për personelin. Prandaj, operatorët ekonomik vendorë nuk kanë mundësi reale ta sigurojnë këtë certifikatë në tregun vendor, ndërsa pajisja me të mund të arrihet vetëm përmes trajnimeve dhe certifikimeve të organizuara jashtë vendit nga organizata të specializuara. Për rrjedhojë, një kërkesë e tillë favorizon operatorë të caktuar ose operatorë që kanë pasur mundësi të ndjekin trajnime jashtë vendit, duke krijuar një pengesë të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë ekonomik. Prandaj siç edhe e cekëm kërkesa e lartcekur duhet të largohet në tërësi nga dosja e tenderit, pasi që nëse një gjë e tillë nuk ndodh atëherë kuptohet qartë se ky aktivitet i prokurimit është përgatitur për një OE të caktuar.

Tek Aneksin 8. PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM, është kërkuar: *8.Makinë e paisur me kamerë për inspektim të kanalizimit me diametër DN200-DN500 e paisur me softuer europian EN 13508-2 2001 min*

Siç është argumentuar edhe në pretendimin e lartcekur lidhur me kërkesën për personel të certifikuar sipas standardit DIN EN 13508-2:2001, edhe kërkesa e paraparë në Aneksin 8 – Pajisjet dhe Mekanizimi i Obligueshëm për posedimin e një makine të pajisur me kamerë për inspektimin e kanalizimit (CCTV) me diametër DN200–DN500 dhe softuer sipas standardit EN 13508-2:2001 nuk është në përputhje me objektin e kontratës. Ky aktivitet i prokurimit ka për objekt ndërtimin e ri të rrjetit të kanalizimit fekal, ndërsa pajisja e kërkuar shërben për inspektimin, diagnostikimin dhe vlerësimin e gjendjes së kanalizimeve ekzistuese. Përderisa në dokumentet e tenderit përkatësisht tek paramasa nuk është paraparë si obligim kryerja e inspektimit CCTV dhe hartimi i raporteve sipas standardit EN 13508-2:2001, kërkesa për këtë pajisje nuk është e nevojshme për realizimin e kontratës. Prandaj kjo kërkesë është joproporcionale, nuk lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve që do të kryhen dhe kufizon në mënyrë të panevojshme konkurrencën, duke vendosur

pengesa të pajustificuara për operatorët ekonomik të interesuar të cilët posedojnë kapacitetet e nevojshme për ndërtimin e kanalizimit, por jo pajisje të specializuara për inspektimin e rrjeteve ekzistuese. Për këtë arsye, kërkojmë që të largohet në tërësi kërkesa e lartcekur me qëllim të hapjes së konkurrencës, sepse nëse një gjë e tillë nuk ndodh atëherë kuptohet qartë se ky aktivitet i prokurimit është përcaktuar për një OE të vetëm i cili i posedon këto pajisje të cilat siç e cekëm janë të panevojshme.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e lartcekura kuptohet qartë se dosja e tenderit nuk është përgatitur në harmoni me legjislacionin në fuqi, pasi që janë vendosur kërkesa diskriminuese të cilat ju pamundësojnë ofertimin kompanive të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht favorizojnë kompani të caktuara.

Ne me dt.10.07.2026 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me arsyetimin se e njëjta është cilësuar si pjesërisht e bazuar.

Autoriteti kontraktues gjatë përgjigjes së saj, në lidhje me pretendimin tonë ankimor sa i përket inxhinierit të kërkuar nga AK-ja, e ka cilësuar pretendimin tonë ankimor si të pa bazuar.

Arsyetimi që AK-ja ka dhënë në vendimin për refuzim të pretendimit tonë ankimor është i paqëndrueshëm për faktin se në asnjë mënyrë e njëjta nuk ka dhënë ndonjë dëshmi apo argument konkret që e tregon të kundërtën e pretendimeve tona ankimore.

Kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues i OSHP-së që ti analizoj në tërësi të gjitha pretendimet tona ankimore dhe pastaj të nxjerrret një vendim meritore në lidhje me ankesën tonë dhe pretendimet tona ankimore, pasi që AK-ja në asnjë mënyrë nuk po jep ndonjë argument konkret në lidhje me refuzimin e pretendimeve ankimore, por po na ofrohen arsyeime të cilat nuk janë profesionale dhe të njëjtat janë më shumë një shabllon i arsyetimit apo përsëritje se sa një arsyetim profesional.

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues se licencimi nga MMPH është i nevojshëm nuk përmban asnjë analizë konkrete që dëshmon lidhjen ndërmjet kësaj kërkeje dhe objektit të kontratës. AK-ja është mjaftuar me deklarime të përgjithshme se licencimi garanton profesionalizëm dhe siguri, pa identifikuar asnjë punim specifik të paraparë në paramasë për të cilin licenca do të ishte kusht i domosdoshëm ligjor ose teknik. Vetë fakti që personi i kërkuar duhet të jetë Inxhinier (Master) i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, me pesë (5) vite përvojë profesionale në fushën përkatëse, garanton në masë të mjaftueshme kapacitetin profesional për menaxhimin e kontratës. Për rrjedhojë, kërkesa shtesë për licencim nga MMPH paraqet një kriter joproporcional, i cili nuk është arsyetuar në mënyrë objektive nga AK-ja dhe, si i tillë, kufizon pa nevojë konkurrencën, në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Kur kemi parasysh të gjitha të lartcekurat, kuptohet qartë se ne jemi vendimi i AK-së është jo profesional dhe i pa mbështetur në dispozita ligjore.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*.

Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të

prokurimit, pa konkurrencë të hapur.

Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit*”.

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se ju si autoritet kontraktues nuk e keni përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e keni pasur parasysh as nenin 17.7 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që *“Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve”*.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë*.

Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj kërkesat të cilat i kontestua më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse aty shkruan qartë se *“Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”*.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

### **VENDIM**

**APROVOHET**, si e bazuar ankesa e OE **Denisi SH.P.K.**

**NDRYSHOHEN** kërkesat, që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*